

# NE KONTRIBUOJMË



# NË VENDIMMARRJE

## DEMOKRACIA DUKE VEPRUAR

JONA (11), EDONIS (10), ERJONA (10), RIAD (11), ERZA (10)



### Pesha e demokracisë nuk matet

Se do të kishim një ditë të fillë plot entuziazëm, pikërisht në fund të vitit shkollor, nuk e kemi menduar asnjëherë. Pjesëmarrja në Punëtorinë e Demokracisë, na gëzoi shumë. Përveç se kemi fituar njohuri të reja, ne u kënaqëm shumë edhe me mënyrën se si na trajtuan trajneret e ekipit „Demos-ti“.

Sikurse edhe vet emërtimi i kësaj Punëtorie, tema kyçe e këtij projekti është demokracia. Koncept ky, i cili ka një domethënie të madhe. Kuptimi i fjalës demokraci është udhëheqje e popullit. Pra, në shtetet demokratike është vetë populli ai, i cili vendos se kush do ta përfaqësojë atë në Kuvend. Demokracia gjithashtu ka edhe elementet e saja, të cilat e plotësojnë atë.

Vazhdoni të lexoni për të kuptuar më shumë rreth këtyre elementeve.

E rëndësishme në demokraci është që respekti për njëri-tjetrin të jetë i pranishëm. Solidariteti i ndërsjell-

të i qytetarëve, gjithashtu e thekson aspektin human të popullsisë. Toleranca, njashtu është mëse e nevojshme, në një shtet ku jetojnë qytetarë të etnive të ndryshme, sikurse ndodh në shtetin tonë. Por, ajo për të cilën dallohet sistemi i demokracisë prej sistemeve tjera të qeverisjes është shprehja e lirë e mendimit. E si mund të ndodh një gjë e tillë, përveçse përmes votës së lirë? Këto pra, janë disa nga elementet më të vlefshme të demokracisë.

Kosova ka demokraci përfaqësuese, me sistem parlamentar. Ne qytetarët e Kosovës, i zgjedhim përfaqësuesit tanë, të cilët janë deputetët. Sistem tjetër i demokracisë përfaqësuese është ai presidencial, ku Presidentin e zgjedh direkt populli, e jo përmes deputetëve. Demokracia na ofron mundësinë që ne si qytetarë t'i zgjedhim deputetët, të cilët na përfaqësojnë neve në Kuvendin e Kosovës. Për këtë temë mund të lexoni në artikullin e përgatitur nga grupi tjetër.



Autorët e artikullit




Puna në grup

**Njohja e të drejtave dhe përgjegjësiave tona, të cilat ne i kemi, na përgatitnin për jetë**

Në pjesën e parë të artikullit, kemi treguar se në shtetin tonë zgjedhja e përfaqësuesve bëhet përmes votës tonë. Pjesëmarrja në procesin zgjedhor nuk është obligative. Mirëpo, gjithsesi është përgjegjësi e jona të dalim dhe të japim kontributin tonë duke votuar. Kjo na bën neve qytetarë aktiv.

Çdo veprimtari e jona e cila ndikon pozitivisht në rrethin ku jetojmë ne, na jep titullin e qytetarëve aktivë. Marrim shembull, si nxënës të klasës së V-të, ne do të mund të përgatishim një video këshilluese, për nxënësit e klasave më të ulëta. E kjo do t'i ndihmonte ata, t'i mësonin më lehtë hapat se si të bëhen qytetarë aktiv. Besojmë, se ky artikull ju ka dhënë informata më shumë për qytetarinë aktive, prandaj iu ftojme edhe juve që të bëheni sa më aktiv në shtetin tuaj.



**Ambient i pastër, shëndet i mirë**



**E duam planetin tonë, prandaj kujdesemi për të**



**Erza duke vizatuar**



**Detyrat e ndara në grup, na bënë më të përgjegjshëm**



**Bota është në duart tona**


## DISA FAKTE RRETH KUVENDIT

ARTIOLA (11), SELAMI (11), XHEVAT (11), NJOMZA (11)



**Tema për të cilën ka diskutuar grupi ynë është Kuvendi. Kemi folur për rëndësinë e tij në demokraci dhe ndikimin e ligjeve në jetën tonë. Ju ftojmë ta lexoni këtë artikull**

Vesa është një vajzë, të cilës i pëlqejnë shumë kafshët. Ajo ka dëshirë që në të ardhmen të bëhet veteri-



nare. Pasi që Vesa jeton në një vend demokratik, ajo ka të drejtën e zgjedhjes së profesionit. Kjo e drejtë është e garantuar me ligj. Këto ligje dhe shumë ligje të tjera, na e rregullojnë jetën. Rregullat që ndryshe njihen si ligje miratohen ose nuk miratohen në Kuvendin e Kosovës. Prandaj, ky institucion është shumë i rëndësishëm. Shteti ynë Kosova ka rreth 1.8 milion banorë. Pra, numri i popullsisë është i madh dhe i gjithë populli nuk mund të marrë vendime në të njëjtën kohë. Atëherë, ne votojmë dhe i zgjedhim

deputetët si përfaqësues. Në Kuvendin e Republikës së Kosovës janë gjithsej 120 deputetë. 100 prej tyre, janë të kombit shqiptar dhe 20 të tjerë të komuniteteve jo shumicë (romë, ashkalinjë, egjiptianë, boshnjakë, serbë, turq dhe goranë). Meqenëse në Kuvend vendoset për ligjet, Kuvendi ka funksion legjislativ. Përveç këtij funksioni, Kuvendi ka edhe dy funksione të tjera, të cilat janë: funksioni kontrollues, sepse mbikëqyr punën e Qeverisë, si dhe funksioni përfaqësues, sepse deputetët që punojnë aty e përfaqësojnë popullin. Ata marrin vendime në emrin tonë. Ne mendojmë se demokracia është forma më e mirë e qeverisjes. Pasi që në demokraci udhëheqim ne si popull, të gjithë duhet të jemi të përgjegjshëm për veprimet tona. Kështu, së bashku e ndërtojmë një demokraci të mirë.



Grupi „Piktorët e Demokracisë“

# LIDERËT E SË ARDHMES JEMI NE

ALTINË (11), EDION (11), SEVIME (11), ELJONA (11), ERLETA (11)



## A e keni menduar ndonjëherë se edhe ju mund të jeni përfaqësues ose udhëheqës të së ardhmes?

Të jesh udhëheqës i së ardhmes do të thotë të përfaqësosh interesat e popullit. Që të marrësh përgjegjësi ta udhëheqësh një vend, duhet t'i posedosh disa vlera dhe t'i plotësosh disa kritere që e fuqizojnë rolin e udhëheqësit të një vendi. Sipas nesh, disa nga vlerat që duhet t'i ketë një kandidat janë: ndershmëria, respekti, solidariteti, përkushtimi, etj. Ndërsa, disa

në duart e popullit, i cili e ka fuqinë më të madhe në demokraci.

Qytetarë të dashur, nëse me gjithë zemër e doni të mirën e popullit dhe brengoseni për të ardhmen e vendit tuaj, bëhuni qytetarë aktiv duke kandiduar për deputetë dhe duke qenë pjesë aktive e procesit zgjedhor. Ju keni mundësi të jeni pjesë e zgjedhjeve qendrore, por edhe e zgjedhjeve lokale. Në zgjedhjet qendrore i zgjedhim deputetët, kurse në ato lokale kryetarët e komunave përkatëse. Këto janë dy llojet e zgjedhjeve në Kosovë.

Vendit tonë i duhen qytetarë që janë të përgjegjshëm dhe aktiv. Prandaj, bëhuni pjesë e ndërtimit të mëtutjeshëm të shtetit tonë. Me angazhim dhe me zbatim të elementeve të demokracisë sigurohet mirëqenia sociale e të gjithë neve.



nga kriteret që kandidatët duhet t'i plotësojnë janë: të jenë qytetarë të atij shteti që kanë kandiduar për deputetë, të jenë mbi moshën 18 vjeçare, të mos kenë kryer vepra penale, etj. Sot, kur i diskutuam këto parime dhe kritere që duhet t'i kenë përfaqësuesit e vendit, menduam se në të ardhmen mund të jemi edhe ne në rolin e përfaqësuesve. Besojmë se të gjitha parimet dhe kriteret do t'i zbatonim me shumë përgjegjësi. Pra, demokracia të jep lirinë të zgjedhësh dhe të kandidosh për t'u zgjedhur si përfaqësues. E tërë kjo është



**Në të ardhmen duam të jemi kandidatë për deputetë dhe duam që populli të jetë i kënaqur me punën tonë**



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Ali Hadri“  
Klasa: V-2  
Vendi: Mirash, Ferizaj